



Pranimi / Dorezimi Prilipi/Predato Received/Delivered	10.05.23	viti god Year	3
Organ / Rrësia Organ / Jednica Org. / Unit	In Prot Br Prot Prot No	Shitja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	4447/2023		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.558/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.558/2023 të datës 27.03.2023, të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_, me adresë banimi Rr. "Hafër Ali Korça" nr.18 lagjia,, Taslixhe "në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Komuna e Prishtinës në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.05.2023, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.558/2023 e datës 27.03.2023 e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_.
- II. Anulohet konkursi i datës 26.01.2022 sipas numrit të referencës RN00010814 për emrin e grupit „Specialistë të Shëndetit dhe Higjienës Mjedisore dhe Profesionale“, i shpallur nga Komuna e Prishtinës lidhur me pozitën "Zyrtar për menaxhimin e mbeturinave", si dhe shfuqizohen të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Personelit në Komunën e Prishtinës, që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Komuna e Prishtinës duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 26.01.2023 ka njoftuar lidhur

me konkursin, ndërsa me datën 16.02.2023 ka shpallur konkursin për praninë për emrin e grupit Specialistë të Shëndetit dhe Higjienës Mjedisore dhe Profesionale, lidhur me pozitën *Zyrtar për menaxhimin e mbeturinave* në Sektorin e Menaxhimit të Kontratave të Ndërtimeve të Larta/Prishtinë ë, për klasën e pozitës Profesional 2.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja. Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, me datën 07.03.2023 ka nxjerrë Vendim, sipas të cilit ankuesja është njoftuar se nuk është përfshirë në listën e ngushtë lidhur me konkursin për pozitën në fjalë, me arsyetimin për mungesë të dëshmisë mbi përvojën e punës si dhe certifikatës mbi evidencën penale.

Kundër vendimit për mos përfshirjen në listën e ngushtë, me datën 10.03.2023 përmes shkresës me numër zyrtar 14-070/01-52045/23, ka parashtruar ankesë në Njësia e Burimeve Njerëzore të kësaj komune. Kjo e fundit me datën 16.03.2023 ka nxjerrë vendim sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë.

E pakënaqur me vendimin lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesja fizikisht me datën 27.03.2023, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2995/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me mos përfshirjen e së njëjtës në listën e ngushtë .

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:2995/2023 të datës 27.03.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër të referencës RN00010814 të datës 26.01.2023; Vendimin e datës 07.03.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 07.03.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Formularin për kërkesë apo ankesë të ankueses të datës 10.03.2023; Ankesën e ankueses me numër 14-070/01-52045/23 të datës 10.03.2023; Dëshmitë lidhur me aplikacionin e ankueses së bashku me dëshminë mbi certifikatën e evidencës penale me numër PN.NR 28068/2022 të datës 02.11.2022, 23.02.2023, Vendimin e datës 16.03.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore, Njoftimin e datës 16.03.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore, Diplomën me numër Nr.1693 të datës 14.12.2012 nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Juridik në Prishtinë, Diplomën me numër Nr.1439 të datës 13.06.2017 nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Juridik në Prishtinë, Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.04.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 26.04.2023 nga Komuna e Prishtinës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Listën me aplikacionet e pranuar të kandidateve të gjeneruar tek SIMBNJ për kandidatët e aprovuar dhe refuzuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankueses *„ është e bazuar, sepse:*

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit „ Specialistë të Shëndetit dhe Higjienës Mjedisore dhe Profesionale”, i shpallur nga Komuna e Prishtinës sipas

konkursit me numër të referencës RN00010814 lidhur me pozitën “Zyrtar për menaxhimin e mbeturinave” në Sektorin e Menaxhimit të Kontratave të Ndërtimeve të Ndërtimeve të Larta/Prishtinë për klasën e pozitës profesional 2, kanë qenë si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.*
- *Kualifikime të posaçme formale: Fakulteti Juridik, Administrim Biznesi, Administrim Publik, Ekonomik Teknik*
- *Pervoja e punës së kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushen për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së shpalljes së konkursit dhe zhvillimit të procedurave të rekrutimit deri në fazën kur ankuesja ka parashtruar ankesë, ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil e cila ka qenë në fuqi në kohën kur është zhvilluar procedura, konkretisht tek shtojca Nr.2, Kodi i grupit 48 të kësaj rregulloreje, janë përcaktuar kriteret lidhur me fushën e kërkuar të arsimit për secilën kategori të shërbimit civil, konkretisht për emrin e grupit *Specialistë të Shëndetit dhe Higjienës Mjedisore dhe Profesionale* fusha e kërkuar e arsimit është ajo: “Higjienë mjedisore dhe profesionale/ Epidemiologji, Shëndet Publik, Mjekësi Sociale”, ndërsa tek kërkesat e përgjithshme formale sipas kushteve të konkursit i shpallur me datën 26.01.2023 sipas numrit të referencës RN00010814 nga Komuna e Prishtinës për emrin e grupit *Specialistë të Shëndetit dhe Higjienës Mjedisore* janë përfshirë drejtimet nga fusha e fakultetit Juridik, Administrim Biznesi, Administrim Publik dhe Ekonomik teknik për fushën e caktuar të arsimit të kërkuar, ndërsa tek përvoja e punës së kërkuar lidhur me pozitën konkrete, organi i punësimit në këtë rast Komuna e Prishtinës ka përcaktuar: *„së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushen për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë”*, ndërsa sipas Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil gjegjësisht tek Shtojca Nr.1/7: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 2 si kriter për përvojën e punës lidhur me klasën e pozitës Profesional 2 është përcaktuar: *„Së paku 1(një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës* andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se me rastin e mos përfshirjes së fushës së arsimit Higjienë mjedisore dhe profesionale/Epidemiologji, Shëndet Publik, Mjekësi Sociale si kriter i konkursit për emrin e grupit *Specialistë të Shëndetit dhe Higjienës Mjedisore dhe Profesionale* dhe përvojës së punës për klasën e pozitës Profesional 2 siç përcaktohet me dispozitat e kësaj rregulloreje, Komuna e Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, konkretisht nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *“Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive”* si dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës konkretisht nenin 4 paragrafin 2 ku përcaktohet se: *“Parimet e pranimit dhe avancimit në karrierë: Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë*



*të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuar në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore”.*

Andaj, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë si dhe analizimit të dispozitave ligjore lidhur me kushtet dhe kriteret e pranimit në shërbimin civil, duke marrë për bazë edhe konstatimet e pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se konkursi i shpallur me datën 26.01.2023 për emrin e grupit Specialistë të Shëndetit dhe Higjienës Mjedisore dhe Profesionale, i shpallur nga Komuna e Prishtinës sipas konkursit me numër të referencës RN00010814 në “Zyrtar për menaxhimin e mbeturinave” në Sektorin e Menaxhimit të Kontratave të Ndërtimeve të Ndërtimeve të Larta/Prishtinë për klasën e pozitës profesional 2, është bërë në kundërshtimin me nenin 4 paragrafin 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe mbi këtë bazë ka vendosur të anulojë konkursin e lartë cekur si dhe të shfuqizojë çdo akt tjetër administrativ që rrjedh nga kjo procedurë e rekrutimit, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar mbi bazën e kësaj të gjeture. Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar më tej në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, meqenëse shpallja e konkursit në fjalë nuk ka qenë në harmoni me dispozitat akteve ligjore të përcaktuara si më lartë.

Nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji duke u bazuar në nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton se një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedurë e paligjshme, kështu që me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.558/2023.

Ardita Perguku-Shyti



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.